

L I G J
Nr.7772, datë 7.12.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7514, DATË 30.9.1991 "PËR PAFAJËSINË,
AMNISTINË DHE REHABILITIMIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE
POLITIKË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7660, DATË 14.1.1993, DHE LIGJIN NR.7719,
DATË 8.6.1993**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin politik të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", ndryshuar me ligjin nr.7660, datë 14.1.1993, dhe ligjin nr.7719, datë 8.6.1993, në nenin 5 bëhen këto ndryshime :

- Në shkronjën "ç/1"

Pas fjalëve "Ish-të burgosurve politikë për kohën e qëndrimit në burg ose në kampet e punës" shtohen fjalët "dhe ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, për të internuarit në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarit në kampin e internimit Zvernec deri më 31.12.1967.

- Në shkronjën "d/1"

Pas fjalëve "Familjeve të ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më" shtohen fjalët "dhe ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, për të internuarit në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarit në kampin e internimit Zvernec deri më 31.12.1967".

- Në shkronjën "dh"

Pas fjalëve "Ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më" shtohen fjalët "ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, për të internuarit në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarit në kampin e internimit Zvernec deri më 31.12.1967"

- Në shkronjën "e"

Pas fjalëve "të të vdekurve në burg" shtohen fjalët "dhe të ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, për të internuarit në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarit në kampin e internimit Zvernec deri më 31.12.1967.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.715, datë 17.12.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.